

MBI VLERËSIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN BUSHAT, SHKODËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Bushat, Shkodër, me objekt: “Mbi Vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, zbatimin e Planit Rregullues të Përgjithshëm, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimit të aseteve, vlerësimin për shitje të trojeve nën objekt, shitjen e trojeve, legalizimin e shtesave në ndërtime, dhënien me qira të objekteve pronë publike, masat për mbrojtjen e mjedisit, vlerësimi i Auditit të brendshëm “ dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.89 , datë 19.06.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 145/8, datë 19.06.2012, dërguar z. **Zef Hila**, Kryetar i komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1- Të merren masa, që hartimi dhe miratimi i projekt buxhetit të bëhet brenda datës 31 Dhjetor, afat i përcaktuar në ligj, si dhe 15 ditë pas miratimit të tyre, të bëhet publikimi në buletin e njoftimeve publike.

Vazhdimisht

2- Të merren masa, që në të ardhmen të ruhet limiti i miratuar i fondeve të programuara.

Vazhdimisht

3- Të merren masa, që në listë pagesa të evidentohet koha e kryerjes së pushimit vjetor të paguar për çdo punonjës sipas strukturës e funksionit të miratuar.

Vazhdimisht

4- Të merren masa, që për periudhën në vazhdim në prokurimet sipas procedurës me vlera të vogla, të mos kalohet kufiri i fondit limit si grup artikujsh për artikuj që janë grup mallrash apo shërbime të ngjashme.

Vazhdimisht

5- Të merren masa, që të bëhen hyrje në magazinë me dokumentacion të rregullt duke plotësuar fletëhyrje materialet e qëndrueshme e qarkulluese që janë vlerësuar e nxjerrë jashtë përdorimit gjatë viti ushtrimor.

Vazhdimisht

6- Të merren masa, që të hartohet raport informimi për Kryetarin e Komunës, mbi gjendjen e aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese dhe destinacionit e përdorimit të tyre dhe t'i dërgohet Kryetarit të Komunës, miratimi i procesverbalit për asgjësimin e materialeve të inventarit, nga Zyra e Financës dhe Komisioni i Vlerësimin.

Vazhdimisht

7- Të merren masa, që në bilancin e vitit 2012, të paraqiten drejtë debitorët, për vlerën 2,128,050 lekë, që janë detyrime të papaguara nga 52 subjekte të biznesit të vogël, për vitin 2010 dhe për vlerën 1,004,340 lekë, që janë detyrime të papaguara nga 42 subjekte të biznesit të vogël, për vitin 2011.

Vazhdimisht

8- Të merren masa, nga Autoriteti Vendor i Planifikimit të Territorit, që të punohet për hartimin e miratimin e instrumenteve vendorë të planifikimit dhe integritit, në përputhje me instrumentet kombëtare të planifikimit.

Menjëherë

9- Të merren masa, nga Autoriteti Vendor i Planifikimit të Territorit, që të ushtrojë kontrollin e zhvillimit të territorit për zbatimin e instrumenteve kombëtare e vendore të planifikimit në territorin e tyre administrativ dhe të marrë masat e nevojshme sipas ligjit për të shmangur shkeljet mjedisore, të shëndetit dhe sigurisë publike e abuzimet në territor.

Menjëherë

10- Të merren masa, nga Autoriteti Vendor i Planifikimit të Territorit, që në të ardhmen shqyrtimi dhe miratimi i lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit dhe lejeve të përdorimit, të bëhet duke u bazuar në instrumenteve vendorë të planifikimit të miratuar, në përputhje me përcaktimet në instrumentet kombëtare të planifikimit.

Vazhdimisht

11- Të merren masa, që të kërkohet në rrugë ligjore shlyerja e detyrimit me vlerë prej 249,071 lekë, për 3 subjekte ndërtuese, si pjesë e detyrimit të pa paguar i taksës së lejes së ndërtimit.

Menjëherë

12- Të merren masa, nga ana e Kryeinspektorit të INUV, të Komunës për shkeljet e konstatuara në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës të aplikojnë sanksione ligjore të parashikuara.

Vazhdimisht

13- Të merren masa, nga ana e Njesisë së prokurimit të Autoritetit Kontraktor (Komuna Bushat) Të inventarizohen në mënyrë të rregullt e arkivohen në përputhje me ligjin “Për Prokurimin Publik” dosjet e prokurimeve.

Vazhdimisht

14- Të merren masa, nga ana e Zyrës së Taksave të përmirësohet organizimi i punës e të ndiqet në vazhdimësi arkëtimi i vlerave debitore.

Vazhdimisht

15- Të merren masa, nga Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik Vendor (INUV), që në bashkëpunim me Zyrën e Urbanistikës, të evidentojë ndërtimet pa leje, duke aplikuar gjoha ndaj subjektet ndërtuese të kundra ligjshme, me qëllim mbajtjen nën kontroll administrimin dhe zhvillimin e territorit.

Vazhdimisht

16- Të merren masa, nga ana e Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të arsyetohen e dokumentohen specifikimet teknike në prokurimet që zhvillohen nga ky autoritet kontraktor.

Vazhdimisht

17- Të merren masa, nga ana e Njesisë së Hartimit të Dokumenteve te bëhet argumentimi i fondit limit në procesverbal. Në rastet e kontratave të punëve të përshkruhet referimi i çmimeve të vendosura në preventiva të projekteve respektive, si dhe të përcaktohen duke u argumentuar kërkesat për kualifikim duke i argumentuar ato në bazë të volumeve të punimeve.

Vazhdimisht

18- Të merren masa, nga ana e Zyrës Juridike dhe të Pronave pranë Komunës të merren masat për administrimin sa më të mirë të aseteve duke dokumentuar çdo procedurë dhënie me qira si dhe ndjekjen në vazhdimësi arkëtimin të detyrimeve kontraktuale të subjekteve ndaj Komunës.

Vazhdimisht

B. MASA DISPLINORE

- Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Kontratën individuale të punës dhe nenin 6 “Masa Disiplinore” të Rregullore së Brendshme të Komunës Bushat, *kërkojmë nga Kryetari i Komunës*, fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore si me poshtë:

I. “Vërejtje me paralajmërim”, për:

1- [REDAKTUAR] me detyrë përgjegjëse e Zyrës së Financës.

Në keq administrimin e vlerave materiale e monetare, inventarizimin dhe gjendjen e aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese si dhe proceduarat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, VKM nr. 70, datë 11.3.1985, i ndryshuar, UMB nr. 1151 datë 16.7.2007 “Për kriteret dhe proceduarat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë së Brendshme”.

[REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, në cilësinë e sekretarit të KRRT-së.

-Për të meta e mangësi në shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të sheshit dhe lejeve të ndërtimit, në mbajtjen e akteve të kontrollit në fazat e ndryshme të ndërtimit të objektit dhe në përlogaritjen e detyrimeve në lidhje me taksën e lejes së ndërtimit. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998, i ndryshuar, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, VKM 722, datë 19.11.1998, “Për rregulloren e urbanistikës” ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit Komunal nr. 2, datë 08.02.2011 “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2011, për taksat e tarifave vendore”.

3- [REDAKTUAR] me detyrë ish-përgjegjës i Zyres së Tatim Taksave ,

-Për një punë të dobët në drejtimin e funksionimit të Zyrës së Taksa Tatimeve për gjithë periudhën e audituar, si veprim në mos përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga neni 34 i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” dhe nenet 111 e vazhdim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore”.

4- [REDAKTUAR] me detyrë kryeinspektor i INUV të komunës .

-Për mos aplikim gjobe në asnjë rast për shkeljet e konstatuara në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës. Veprime në kundërshtim me, germën “b” të nenit 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” i ndryshuar.

II. Vërejtje me shkrim, për:

1- [REDAKTUAR] me detyrë inspektore finance,

-Për të meta e mangësi në listë pagesat e përgatitura, ku nuk ishte pasqyruar funksioni sipas strukturës së miratuar, nuk është e evidentuar koha e kryerjes së pushimit vjetor të paguar. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” i ndryshuar dhe VKM nr. 290, datë 14.6.1993 “Për limitin e arkës në ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore”.

2- [REDAKTUAR] me detyrë arkëtar,

-Për të meta e mangësi se nuk ishin derdhur çdo ditë në bankë, mjetet monetare të arkëtuara, duke mbajtur ato më shumë se limit ditor i lejuar. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 290, datë 14.6.1993 “Për limitin e arkës në ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore”.

3- ■■■■■ me detyrë, Nën kryetar; ■■■■■ me detyrë, përgjegjës investimesh; ■■■■■ me detyrë, Sekretar Këshilli; ■■■■■ me detyrë, Jurist, dhe ■■■■■ me detyrë, Inspektore Tatimesh, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të asgjësimit.

-Për të meta e mangësi në administrimin, inventarizimin dhe gjendjen e aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese si dhe proceduarat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, VKM nr. 70, datë 11.3.1985, i ndryshuar, UMB nr. 1151, datë 16.7.2007 “Për kriteret dhe proceduarat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë së Brendshme”.

4- ■■■■■ me detyrë inspektor i urbanistikës.

-Për të meta e mangësi në shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të sheshit dhe lejeve të ndërtimit, në mbajtjen e akteve të kontrollit në fazat e ndryshme të ndërtimit të objektit. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998, i ndryshuar, ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, VKM 722, datë 19.11.1998, “Për rregulloren e urbanistikës” ndryshuar.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Muhamet Kavaja dhe Xhevdet Haxhiu. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT